

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
DEPARTAMENTI: LAVËRTARI & PERIMTARI**



***HULUMTIMI I DISA MATERIVE MINERALE NE SPECIEN E
KAMOMILIT (Matricaria chamomilia L.) NË LOKALITETET E
OBILIQIT***

PUNIM DIPLOME MASTER

Mentori:

Prof. Dr. Imer Rusinovci

Kandidati:

Fatbardh S. HAZIRI

Prishtinë, dhjetor - 2024

P ë r m b l e d h j e

Mjekësia bashkëkohore botërore ka një prirje strategjike për të kaluar drejt burimeve natyrore me më shumë kërkime për prodhimin e ilaçeve të reja, që vijnë nga bimët mjekësore aromatike. Bimët mjekësore jo vetëm në periudhën e kaluar, por edhe në ditët e tanishme mbeten burimi dhe pasuria më madhe e njeriut, në luftën kundër sëmundjeve të ndryshme. Andaj, e ndërmorrëm këtë studim, që të fokusohemi në vetitë e çmuara të bimes së Kamomilit (*Matricaria chamomilia L.*). Qëllimi i hulumtimit është përcaktimi i përmbajtjes së elementeve minerale: Fe (Hekurit), Ca (Kalciumi), Zn (Zinkut), dhe Mn (Manganit) në rajonin e Obiliqit të bima e kamomilit. Përveç analizave kimike për përmbajtjen e elementeve minerale, qëllim i punimit është edhe përmbajtja e vajit eterik të bima e Kamomilit (*Matricaria chamomilia L.*) në rajonin e Obiliqit. Për realizimin e këtij hulumtimi janë marrë 20 mostra standarde të bimës së Kamomilit (*Matricaria chamomilia L.*), në kushtet agro-ekologjike të lokalitetit të Obiliqit (në fshatin Breznicë të Komunes së Obiliqit). Analiza e variancës për parametrat e hulumtuar dha vlerë të probabilitetit lartë sinjifikante për të dy nivelet $p= 0.05$ dhe 0.01 . Hulumtimet tona treguan se me përmbajtje të lartë ishte $Ca = 2127.4 \text{ mg kg}^{-1}$, ndërsa më të ulët ishte Zinku ($Zn = 3.94 \text{ mg kg}^{-1}$). Përmbajtjen e vajit eterik më të ulët e realizuan mostrat e para në raport me mostrat tjera (0.8% dhe 0.9% të fillimit, ndërsa 1.0% dhe 1.2% mostrat e radhës.

A b s t r a c t

Contemporary world medicine has a strategic tendency to move towards natural resources with more research into the production of new medicines, which come from aromatic medicinal plants. Medicinal plants, not only in the past, but also in the present day, remain the source and the greatest wealth of man, in the fight against various diseases. Therefore, we undertook this study to focus on the valuable properties of the Chamomile plant (*Matricaria chamomilia* L.). The purpose of the research is to determine the content of mineral elements: Fe (Iron), Ca (Calcium), Zn (Zinc), and Mn (Manganese) in the region of Obiliq in the chamomile plant. In addition to the chemical analysis for the content of mineral elements, the purpose of the work is also the content of the essential oil of the Chamomile plant (*Matricaria chamomilia* L.) in the region of Obiliq. For the realization of this research, 20 standard samples of the Chamomile plant (*Matricaria chamomilia* L.) were taken, in the agro-ecological conditions of the locality of Obiliq (in the village of Breznicë, Municipality of Obiliq). The analysis of variance for the researched parameters gave a value of high probability significant for both levels $p= 0.05$ and 0.01 . Our research showed that the highest content was $Ca = 2127.4 \text{ mg kg}^{-1}$, while the lowest was $Zinc (Zn) = 3.94 \text{ mg kg}^{-1}$. The first samples achieved the lowest essential oil content in relation to the other samples (0.8% and 0.9% of the beginning, while 1.0% and 1.2% of the next samples).